



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVA
KOMISIONI I PAVARUR I MEDIAVE
NEZAVISNA KOMISIJA ZA MEDIJE
INDEPENDENT MEDIA COMMISSION



Mbështetur në nenin 3, paragrafi 2, pika 1; nenin 3, paragrafi 2, pika 4; nenin 9, paragrafi 3 dhe nenin 23 paragrafi 1 të Ligjit Nr.04/L-44 për Komisionin e Pavarur të Mediave dhe duke u bazuar në nevojën e banorëve të komunitetit turk të Komunës së Prizrenit si dhe banorëve të komunitetit boshnjak të Vitomiricës, Komuna e Pejës, për informacion të karakterit lokal në gjuhën e tyre amtare, interesimin për frekuenca të radios si dhe mundësin e zhvillimit të pluralizmit medial në këto lokacione, Komisioni i Pavarur i Mediave (KPM) në takimin e tij të mbajtur më datën 17 korrik 2023, merr këtë:

VENDIM


1. Për shpalljen e konkursit publik për frekuenca të lira për transmetim tokësor të radios - në Komunën e Prizrenit një (1) radio me mbulueshmëri regjionale në gjuhën turke - dhe në Vitomiricë, Komuna e Pejës - një (1) radio me mbulueshmëri lokale në gjuhën boshnjake.
2. Konkursi do të jetë i hapur 30 ditë nga publikimi i tij dhe do të kenë mundësin që të aplikojnë të gjithë të interesuarit.

Arsyetimi

3. Ligji Nr. 04/L-44 për Komisionin e Pavarur për Media, përcakton se KPM është organ i pavarur i cili është kompetent për rregullimin, menaxhimin dhe mbikëqyrjen e spektrit të frekuencave të transmetimit si dhe rregullon të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësit e personave fizik dhe juridik të cilët ofrojnë shërbime mediale audio-vizuale.
4. Neni 21, paragrafi 1 i Ligjit të KPM-së përcakton se: *“për të ushtruar transmetim në Kosovë sipas kushteve të këtij ligji kërkohet licenca për transmetim, të cilën e lëshon KPM-ja”*.
5. Ndërsa, Neni 23, paragrafi 1 të Ligjit për KPM-në, përcakton: *“Kur KPM-ja vendos të lëshojë licenca të reja për shërbime mediale audiovizuale, do ta publikojë gjerësisht një njoftim për këtë qëllim përmes Zyrës Ekzekutive. Në njoftim përfshihet i tërë informacioni përkatës për licencat e propozuara të shërbimeve mediale audiovizuale, procesi për dorëzimin e aplikacioneve, informacioni që kërkohet nga kandidatët, metodologjia dhe kriteret për vlerësimin e aplikacioneve për licencat e shërbimeve mediale audiovizuale, dhe tarifatat e përcaktuara për aplikacionin dhe për kategorinë e licencës.”*



6. Duke marrë parasysh se në Komunën e Prizrenit jeton një komunitet i konsiderueshëm i përkatësisë turke dhe nuk ka radio apo TV të licencuar për transmetim në gjuhën turke si dhe duke marrë parasysh edhe kërkesën e këtij komuniteti për licencë të radios, Komisioni konsideron se shpallja e konkursit për frekuencë të lirë të radios në gjuhën turke, në këtë Komunë, është i nevojshëm dhe do të ndikonte pozitivisht në zhvillimin e pluralizmit medial, si dhe do ti ofrohet mundësia komunitetit turk për informim në gjuhën amtare dhe me programe të karakterit lokal.
7. Komisioni, konstaton se nga viti 2021, në vazhdimësi ka pasur interesim për licencë të radios në gjuhën boshnjake në Vitomiricë, i parashtruar në mënyrë formale me shkrim si dhe në formë të interesimeve gjatë takimeve të zhvilluara në KPM, dhe se në arsyetimin e tyre është cekur edhe mungesa e informacionit lokal në gjuhën boshnjake.
8. Duke marrë parasysh kërkesat dhe nevojat e qytetarëve të këtyre lokacioneve për qasje në informacion të karakterit lokal në gjuhën e tyre amtare, interesimin dhe kërkesat për licencë të radios për këto lokacione si dhe mundësin e zhvillimit të pluralizmit medial, Komisioni konstaton se ka arsye të mjaftueshme dhe është e rëndësishme shpallja e konkursit publik për lokacionet e lartcekura.
9. Bazuar në arsyetimet e cekura më lartë, Komisioni vendosi si në dispozitivin e këtij vendimi.



Jeton Mehmeti

Kryetar

Komisioni i Pavarur i Mediave



01.08.2023

Datë